



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, më 17.10.2022

Vendimi nr. 38/22

Duke u bazuar në nenet 28, 29, 34, 35 dhe nenin 54, paragrafi 2.3 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas shkresës nga Oda e Afarizmit të Kosovës, kundër ndërmarrjes SharrCem Sh.p.k, me pretendimin për keqpërdorim të Pozitës Dominuese, në mbledhjen e mbajtur me datën 17.10.2022, merr këtë:

KONKLUZION

- I. Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant Autoriteti konstaton se nuk argumente për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjes SharrCem Sh.p.k, lidhur me pretendimet për çmime abuzive të çimentos.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 02.04.2022, ka pranuar shkresë përmes emailit nga Oda e Afarizmit të Kosovës, e cila ka shprehur shqetësimet me ngritjet e çmimit të çimentos nga ndërmarrja SharrCem Sh.p.k, në të cilin kanë pretenduar se qëllimi i tyre është mbrojtja e të drejtave, interesave të bizneseve si dhe delegimi i shqetësimit të tyre tek institucionet përkatëse. Sipas njoftimeve që janë bërë dhe po bëhen nga kompania, në afat shumë të shkurtër, edhe në të kaluarën i kanë dëmtuar rëndë bizneset të cilat furnizohen me lëndë të parë nga të njëjtit. Dëmtimi vjen si rezultat i kontratave të mëhershme që bëjnë bizneset, e në të cilat ndër tjera të përcaktohet edhe çmimi i furnizimeve, e të cilët detyrohen t'iu përmbahen atyre çmimeve që kanë kontraktuar disa muaj më herët.

Lidhur me këtë, duke marrë parasysh që kompania "SharrCem" Sh.p.k është e vetmja kompani ne Republikën e Kosovës, e cila furnizon kompanitë tjera me çimento, do të duhej që kjo e fundit të bëjë paralajmërime për ndryshime të çmimeve disa muaj më herët në mënyrë që kompanitë blerëse të kenë mundësi të ripërcaktimit të çmimeve shitëse.

Sipas të dhënave nga bizneset tona anëtare, "SharrCem" Sh.p.k me datën 17.12.2021 ka njoftuar për vendimin e aplikimit të çmimeve të reja të çimentos, vendim ky i cili ka hyrë në fuqi me

01.01.2022 përkatësisht 15 ditë pas njoftimit. Ndërsa, një njoftim tjetër për ndryshimin e çmimeve është bërë me 09.03.2022 dhe ka hyrë në fuqi me 14.03.2022, pra në një diferencë për reagim nga bizneset, vetëm pesë ditë.

Koha shumë e shkurtër e paralajmërimit për ndryshime të çmimeve që “SharrCem” Sh.p.k po u lë në dispozicion bizneseve të cilat furnizohen me çimento, po i dëmton këto të fundit që realizojnë kontratat me çmimet e parapara, gjë e cila po shkaktojnë një nivel të lartë të pakënaqësisë tek bashkëpunëtorët e tyre, madje disa edhe po bëjnë ndërprerje të bashkëpunimit.

Tregu relevant

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën e përcaktimit të tregut relevant Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit - konsiderohet prodhimi dhe shitja e produkti të çimentos: çimento 42.5R- (refuz) dhe thasë.

Aktivitetet e zhvilluara në shqyrtimin e hetimit paraparak të tregut përkatës dhe korniza ligjore

1. Me datën 10.08.2022 Oda e Afarizmit të Kosovës ka organizuar një punëtori, ku përfaqësuesit e Autoritetit kanë marrë pjesë së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Përfaqësuesit e bizneseve të sektorëve të ndërtimit dhe prodhuesit e betonit në Kosovë, në këtë punëtori është diskutuar ngritja e çmimit të çimentos nga ndërmarrja SharrCem Sh.p.k.
2. Me datën 17.08.2022 kemi monitoruar tregun e çimentos në rajonin e Komunës së Prishtinës dhe Ferizajt me ç ‘rast kemi takuar përfaqësuesit e kompanive: Betonjerka “NOTI” Obiliq, NB Company Shpk në Lazarevë, Betonjerka “New Premix” Shpk në Prishtinë, që merren me prodhimin e betonit, dhe Ndërmarrjen “Fitorja” Shpk në Ferizaj të cilat merren me shit-blerjen e çimentos dhe prodhimin e betonit.
3. Me datën 18.08.2022, kemi monitoruar tregun e çimentos në rajonin e Komunës së Ferizajt dhe Kaçanikut, kemi takuar përfaqësuesit e kompanive: “Besimi Comerc” Shpk në Shtime, “Jehona IJT” Shpk në Kaçanik, të cilat merren me shit-blerjen e çimentos.
4. Më datën 25.08.2022 kemi monitoruar tregun e çimentos në rajonin e Komunës së Podujevës ku kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e kompanisë: “Malësia Comerce“ Podujevë, kompani e cila merret me shit-blerjen e çimentos.
5. Me datën 26.08.2022, kemi monitoruar tregun e çimentos në rajonin e Komunës së Prishtinës, respektivisht ndërmarrjen “Cement Plus For Building Materials L.L.C”, e cila merret me shitblerjen e çimentos të importuar nga Maqedonia e Veriut.

1. Analiza e Konkurrencës

- a) Lidhur me pretendimet e Odës së Afarizmit të Kosovës se kompania SharrCem Sh.p.k ka keqpërdorur pozitën dominuese lidhur me ngritjen e çmimeve të çimentos brenda një periudhe të shkurtër disa herë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka monitoruar sjelljen e kësaj kompanie në treg, konkretisht lidhur me çmimet jo reale të shitjes së produktit të çimentos, duke e marrë parasysh çmimet e prodhimit dhe çmimet e importit.
- b) Lidhur me ngritjen e çmimeve të çimentos nga prodhuesi vendor kompania SharrCem Sh.p.k nga janari i vitit 2022, deri më 08.08.2022, kishte pasur rritje të çmimeve përafërsisht rreth 38.65% ndërsa për produktin Cem II/B (P-W) 42.5 N-Refuz (Bulk) në vitin 2022 ishte ngritur çmimi për rreth 38.018 %.
- c) Kompania prodhuese SharrCem Sh.p.k posedon kontratë për shitjen e produkteve të çimentos me klientët, në nenin 3 të kontratës i referohet njoftimit të secilit blerës në lidhje me çfarëdo ndryshimi të çmimit. Neni 3 i kontratës është si në vijim:
“Sasia e kontraktuar sipas Nenit 1 të kësaj Kontrate mund t’i shitet Blerësit nga Shitësi sipas çmimeve që janë në fuqi në datën kur produktet i dorëzohen Blerësit. Shitësi duhet të informojë Blerësin, sipas kërkesës së Blerësit, mbi çmimet që janë në fuqi në momentin kur Blerësi shpreh interesimin për të blerë produktet sipas kësaj Kontrate. Për shmangien e çfarëdo dyshimi, Shitësi nuk ndërmerrë asnjë detyrim për t’i shitur Blerësit çfarëdo sasive minimale të produkteve të Shitësit me çmimet që janë në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.”
- d) Fabrika e Çimentos SharrCem Sh.p.k me datën 17.12.2021, kishte njoftuar klientët me çmimet e reja që do të hyjnë në fuqi nga data 01.01.2022, njoftimi i dytë për çmimet e reja ishte bërë më datën 09.03.2022, e të cilat do të hyjnë në fuqi nga data 14.03.2022, ndërsa njoftimi i fundit ishte bërë më datën 03.08.2022, me të cilin kishte njoftuar klientët se me çmimet e reja që do të hyjnë në fuqi nga data 08.08.2022.
- e) Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak, të ndërmarrjes SharrCem Sh.p.k, në lidhje me kontratat për shitjen e produkteve të çimentos, ka konstatuar se ndërmarrja prodhuese nuk kishte zbatuar kushte të ndryshme për blerësit, për t’i vendosur në pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën.
- f) Autoriteti konsideron se çmimet e kompanisë SharrCem Sh.p.k ishin transparente, klientët ishin njoftuar për ndryshimin e çmimeve sipas kontratës, blerësit kanë pas mundësi zgjedhje të kompanitë tjera të cilat importojnë dhe shesin produktet e çimentos, të cilat janë përafërsisht 50 kompani, konkurrenca në këtë treg është e përqendruar në shumë kompani importuese të cilat produktin e çimentos e importojnë nga vendet e rajonit. Sipas analizës kompania SharrCem Sh.p.k nuk ka kapacitet t’i mbulojë nevojat e çimentos në Kosovë, për shkak se prodhimi i saj në raport me importin është rreth 50%.
- g) Autoriteti bëri krahasimin e çmimeve për periudhën janar-gusht të vitit 2022 çmimi mesatar importues nga Shqipëria ishte rreth 90.76 euro për ton, nga Maqedonia e Veriut ishte rreth 96.96, kurse mesatarja e përgjithshme e çmimeve të ndërmarrjes SharrCem Sh.p.k ishte rreth 94,87 euro për ton.

- h) Çmimet e ndërmarrjes SharrCem Sh.p.k, deri në muajin gusht të vitit 2022 kanë qenë më të larta se çmimet e importit nga Shqipëria rreth 4,53%, kurse krahasuar me Maqedoninë e Veriut kanë qenë më të ulëta rreth 2,16%.
- i) Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë monitorimit të sjelljes së kompanisë SharrCem Sh.p.k, nuk gjeti se çmimet e çimentos të vendosura janë abuzive të larta apo çmimet të tepruara për faktin se nëse i krahasojmë çmimet e prodhimit vendor dhe vendet e rajonit, në Kosovë çmimet janë përafërsisht të njëjta me çmimet e importit dhe të rajonit, kemi një dallim të vogël në çmime.

II. Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

KOMISIONI

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Neime Binaku - Isufi
Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare



Besim Stublla
Anëtar



Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Paraqitësi i kërkesës
- Arhiva